

Data e dorëzimit të raportit:	03.07.2024				
Emri i komunës	Mitrovicë e Jugut				
Emri i Kryetarit të Komunës	z. Bedri HAMZA				
Emri i Zyrtarit Komunal për Integritime Evropiane :	zrj. Sadije JASHARI				
Detajet kontaktuese:					
<p>• BLOKU I: KRITERET POLITIKE</p> <p>1. ADMINISTRATA PUBLIKE</p>					
1.1. Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivelin lokal, përfshirë komunat e sapo formuara, duke ofruar udhëzime nga niveli qendror tek ai lokal	Burimet njerëzore	1. A është hartuar programi i trajnimeve për vitin 2024 në komunën tuaj? Nëse po, ju lutemi të ofroni një dokument të tillë.	1. A ka hartuar komuna juaj Startejinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, nëse po ju lutem të bashkangjiteni strategjinë e miratuar?		
1.2. Të ngritet transparencja dhe punës dhe vendimmarrjes të nivelit lokal	Zyra Kryetarit / Zyra informimit				
		<p>Po, komuna e Mitrovicës e ka të hartuar planin e trajnimeve për vitin 2024 të cilin do ta gjeni në dokumentat përçjellëse.</p>	<p>1. Komuna jonë nuk e ka të hartuar Strategjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun por ka të hartuar të gjitha dokumentet që parashihen me Udhëzuesit Administrativ (MAP) Nr. 03/2022 për Transparencë në Komuna, si; Rregulloren Komunale për Transparencë dhe Planin e veprimit për Transparencë.</p> <p>2. Po, Komuna e Mitrovicës ka Planin vjetor të</p>		<p>Neni 120 i MSA-së: Administrata publike</p>



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E MITROVICES-KOMUNA MITROVICA

02 01-082/01-0044123 /m

Pr. J. JASHARI

Dalldi: 03-07-2024

Mitrovicë Mitrovica

		<p>2. A ka komuna juaj Planin vjetor të komunikimit, nëse po ju lutem të bashkangjitni Planin ?</p> <p>3. A është duke u zbatuar Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të hapur në Komuna.</p> <p>4. A është caktuar zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik në komunën tuaj? Ju lutem bashkangjitni vendimin.</p> <p>5. Lidhur me rezultatet e procesit të konsultimit publik, a publikon komuna juaj raportin me të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe a ofron sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesuara. (ju lutem e bashkangjitni linkun e publikimit të raporteve)?</p>	<p>Komunikimit, të cilin mund ta gjeni përmes linkut të bashkangjitur;</p> <p>https://kk.rks-gov.net/mitrovicejugut/wp-content/uploads/sites/18/2024/01/Plani-i-Punes-se-Zyres-per-Komunikim-me-Publikun-per-vitin-2024-K.M.pdf</p> <p>3. Po, Komuna është duke e zbatuar Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komunë.</p> <p>4. Po, me vendim nga ana e Kryetarit është caktuar zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimeve publike.</p> <p>https://kk.rks-gov.net/mitrovicejugut/wp-content/uploads/sites/18/2022/10/Scan10001-1.pdf</p> <p>5. Po. Në vijim gjeni linkun ku janë të publikuara raportet nga konsultimet publike në ueb faqe zyrtare të komunës;</p> <p>https://kk.rks-gov.net/mitrovicejugut/?page_id=100082556</p>	
--	--	--	---	--

<p>1.3.Të vazhdohet procesi i decentralizimit për komunat: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zvecan, Leposaviq</p>	<p>Drejtoria e Administratës</p>	<p>1. A janë emëruar Drejtorët e Drejtorive në komunën tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i Drejtorive në komunën tuaj?</p> <p>3. A është themeluar Qendra për shërbim të qytetarëve?</p> <p>4. A është duke funksionuar sistemi i intranetit në kuadër të shërbimeve administrative që ofron komuna juaj?</p> <p>5. A është arritë të bëhet migrimi i të dhënave nga uebfajta e vjetër në atë të re?</p>	<p>Vlenë vetëm për Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zvecan dhe Leposaviq</p> <p>////////// ////////// ////////// ////////// //////////</p>	
<p>3.SHOQËRIA CIVILE</p>		<p>3.1.Të rritet bashkëpunimi në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të Qeverisë së Kosovës, si dhe të sigurohet financim publik për shoqërinë civile</p>	<p>Drejtoria për Financa Buxhet</p>	<p>1. Komuna e Mitrës për financim të OSHC-ve, ka ndarë buxhet prej 200,000.00 euro (njëzetmijë euro).</p> <p>2. Për periudhën janar-qershor 2024, numri i OSHC-ve të përkrahura financiarisht nga komuna jonë, është 10 OSHC.</p>

		<p>juaj, projekte të OJQ-ve për përkrahjen e komuniteteve.</p> <p>4. Nëse po, specifikoni numrin e projekteve të përkrahura dhe ju lutem ofroni shumën totale të këtyre projekteve?</p> <p>5. A është bërë publikimi i thirrjeve dhe përfituesve në web faqet zyrtare të Komunës, nëse po bashkangjiti linkun.</p>	<p>Pyetjet: 3 dhe 4. Nuk na janë ofruar të dhëna !</p> <p>5. Po, është bërë publikimi i thirrjeve në web faqen komunale.</p>	
4. LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT				
<p>4.1. Të përforcohen strukturat e Kosovës në parandalimin dhe eliminimin e akteve terroriste dhe financimit të tyre</p>	<p>Drejtoria Arsimi</p> <p>a</p> <p>/ Zyra Kryetarit</p> <p>e</p>	<p>1. A keni organizuar ndonjë trajnim ose fushatë vetëdijëse për parandalimin e të rinjve që janë në rrezik për ekstremizëm dhe se si të veprojnë në raste të tilla ?</p> <p>2. Cilat janë veprimet/aktivitetet që ka ndërmarrë komuna e juaj për vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizimit që mund të shpiejë në ekstremizëm të dhunshëm ?</p>	<p>1. Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe OSBBE-në është organizuar një punëtori një ditore regjionale me përfaqësues të Policisë, Drejtorive Komunale të Arsimit, përfaqësues të KKSBB-ve, përfaqësues të minoriteteve dhe klerikëve fetar, me temën ekstremizmi dhe radikalizimi.</p> <p>2. Për periudhën raportuese, përveç takimeve të KKSBB-së, nuk ka pasur ndonjë aktivitet tjetër.</p>	<p>Neni 92: Lufta kundër terrorizmit - MSA</p>

		<p>3. A ka pasur ndonjë rast të raportuar në KKSBB për aktivitetet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin?</p>	<p>3. Për periudhën raportuese, nuk ka pasur ndonjë rast të raportuar në KKSBB.</p>	
<p>4.2. Të krijohen mekanizma për raportim obligativ lidhur me konfliktin e interesit si dhe të ashpërsohen sanksionet lidhur me mos deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit, si dhe për zbatimin e politikave të tjera kundër korrupsionit</p>	<p>Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës</p>	<p>1. Sa është numri i rasteve të paraqitura të konflikteve të interesit nga zyrtarët komunal? 2. Sa është numri i anëtarëve të kuvendit që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të komunës?</p>	<p>1. Kemi 1 rast (e dhënë nga Zyra e Personelit)</p> <p>2. Nuk ka pasur raste të konfliktit të interesit nga anëtarët e kuvendit.</p>	

<p>4.3. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsion;</p>	<p>Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës</p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Planin Lokal për Integritet, konform Ligjit Nr. 08/L-017 për agjencin për parandalimin e korrupsionit nëse po ju lutem të bashkangjiteni planin e miratuar?</p> <p>2. A ka komuna juaj koordinator që monitoron dhe raporton lidhur me planin për integritet, nëse po ju lutem të bashkangjiteni vendimin.</p>	<p>1. Po, Komuna e Mitrovicës së Jugut e ka të hartuar dhe të miratuar Planin për Integritet me Vendimin 01-060/01-0085864-3/23, dt. 22.12.2023, konform Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për parandalimin e Korrupsionit, të cilin Vendimin dhe Planin, e keni të bashkëngjitur në dokumentat përcjellëse.</p> <p>2. Po, komuna e ka të caktuar personin përgjegjës, i cili e monitoron dhe raporton lidhur me këtë plan. (Në vendimin për miratim të planit, e gjeni edhe emrin e personit përgjegjës).</p>	
<p>4.4. Të përmirësohet implementimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve</p>	<p>Zyra ligjore/Zyra informimit</p>	<p>1 Çfarë veprime ka ndërmarrë Komuna për të krijuar qasje për shërbime në gjuhët zyrtare në nivel komunal, duke përfshirë gjuhët në përdorim zyrtarë, sipas UA. Nr. 01/2022.</p> <p>2.A publikohen të gjitha aktet komunale në gjuhët zyrtare ashtu sic parashihen me ligjin për përdorimin e gjuhëve si dhe rregullores komunale për gjuhët zyrtare?</p>	<p>1. Në ueb faqe është i publikuar Udhëzuesi për të drejtat e përdorimit të gjuhëve zyrtarëve, si dhe broshura të ndryshme për promovimin e të drejtave gjuhësore për të gjitha komunitetet.</p> <p>Linku: https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/wp-content/uploads/sites/18/2018/07/Udhezues-per-te-drejtat-e-perdorimit-te-gjuheve-zyrtare.pdf</p> <p>2. Po, konform kësaj Rregulloreje bëhet edhe publikimi i akteve komunale në ueb faqen zyrtare</p>	

5. MBROJTJA DHE PROMOVIMI TRASHËGIMISË KULTURORE

5.1. Avancimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore

Drejtoria e Kulturës/
Drejtoria për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)

2. A është themeluar Muzeu i Natyrës në Komunën tuaj?
(Fushë Kosova)

Vlenë vetëm për Fushë Kosovën



legjislacioni që ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

1. A ka hartuar komuna juaj Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore konfrom Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore ?

2. Nëse jo cilat janë sfidat/arsyjet që komuna juaj ende nuk e ka hartuar Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore ?

3. Sa është numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura?

4. Çfarë masa janë ndërmarrë ndaj shkeljeve të evidentuara të ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura?

3.A janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të tërësive të objekteve të trashëgimisë kulturore (objektet e kultit fetar, zonat e mbrojtura, muzetë, etj) ?

6. A janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse? **(Vetem komunat që kanë kisha) ?**

hartuar planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore . (DKRS-ja)

2.Mitrovica e ka Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore dhe sfidë është se kemi kompetenca të përziera dhe si drejtori nuk kemi zyrtar i cili meret me trashëgimi Kulturore. Tani kemi te planifikuar që në sfafin e DKRS-së, përkatësisht Muzeut, të punësohet zyrtari i cili meret me trashëgimi kulturore ku edhe kemi mare disponueshmerin e mjeteve financiare per poziten ne fjale. (Raporti nga *Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport*

3.Në komunën e Mitrovicës nuk janë evidentuar ndërtime pa leje brenda zonave të veçanta.

4.Inspektorët Komunal të Ndërtimit në kuadër të përgjegjësiave dhe kompetencave, kryejn mbikëqyrjen e ndërtimeve me leje dhe pa leje ndërtimore, përfshirë ndërmarrjen e masave dhe veprimeve që parashihen në dispozitat relevante ligjore.

Në rastin e evidentimit të ndërtimeve pa leje, inspektorati komunal i ndërtimit vepron me ndërmarrjen e masës së veçantë në ndalimin e punimeve deri në një vendim tjetër, shqiptimin e gjobave administrative dhe rrënimin e objekteve në fjalë.

Pyetjet 5 dhe 6 është nën kompetencë të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore (*Urbanizmi*).

Ndërsa sa i përket objektit të muzeut të Mitrovicës, i cili objekt është nën mbrojtje, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport raporton se ka të siguruar roje 24 orë , ku është masë e sigurisë ndërsa kamera nuk ka të vendosura.

Drejtoria e Kulturës/ Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)/ Inspektorati Komunal

<p>5.3.Zbatimi i Ligjit për Hoçën e Madhe. Krijimi i Këshillit të fshatit dhe zgjedhja e anëtarëve për zbatimin e Ligjit për Hoçën e Madhe? Arsyet nëse nuk është bërë ende dhe cilat janë planet tuaja dhe të komunës</p>	<p>Sekretaria e Kuvendit Komunal/Zyra për Fshatin Hoqë e Madhe</p>	<p>1. Cilat janë veprimet që komuna e Rahovecit ka ndërmarrë për funksionimin e Këshillit për Hoçën e Madhe?</p> <p>2. A është alokuar buxheti për Këshillin e fshatit të Hoqës së Madhe për të mundësuar funksionimin e suksesshëm dhe sa është shuma?</p>	<p><i>Vlenë vetëm për Hoçën e Madhe</i></p> <p>//////////////////////////////////// //////////////////////////////////// ////////////////////////////////////</p>	
<p>5.5.Ndërmarrja e veprimeve në adresimin e problemit të ndërtimeve ilegale brenda Zoneve të Veçanta të Mbrojtura (ZVM)? Raportim mbi aktivitetet e ndërmarrja nga Task Forca e ngritur për t'u marrë posaçërisht me ndërtimet e paligjshme në Prizren. Planet e</p>	<p>Sekretaria e Kuvendit Komunal</p>	<p>1. Cilat janë veprimet e komunës për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit?</p>	<p><i>Vlenë vetëm për Prizrenin</i></p> <p>//////////////////////////////////// //////////////////////////////////// ////////////////////////////////////</p>	

<p>ardhshme për këtë Task Force sipas qeverisë së re</p>			
<p>2.A është alokuar buxheti për këshillin e Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit për të mundësuar funksionimin e suksesshëm dhe sa është shuma?</p>			
<p>3.Sa është numri i ndërtimeve ilegale brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e Prizrenit?</p>			
<p>4.Çfarë aktivitete ka ndërmarrë Task Forca për sa i përket ndërtimeve të paligjshme, në Komunën e Prizrenit?</p>		<p>//////////////////////////////////// //////////////////////////////////// //////////////////////////////////// ////////////////////////////////////</p>	
<p>5. A janë caktuar inspektorët komunal për të inspektuar ndërtimet pa leje në Zonën e Mbrojtur të qytetit?</p>			
<p>6. Cfarë aktivitete ka ndërmarrë komuna e Prizrenit me qëllim të rehabilitimit të shtratit të lumit Lumbardhi?</p>			
<p>5.6. Raportoni lidhur me organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe promovimin e përkushtimit më të</p>	<p>Drejtoria e Kulturës</p>	<p>1.Listoni aktivitetet që komunat ka ndërmarrë për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ?</p>	<p>1. Gjatë periudhës raportuese, komuna ka përkrahur aktivitete kulturore duke pasur për qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Janë oraganizuar debate ku është diskutuar në</p>

fuqishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore			<p>lidhje me kompetencat e Trashëgimisë kulturore, saktësisht kompetenc e kujtë është Trashëgimia Kulturore, ku më pas kemi dalur me disa konkluzione se si të mbrohet dhe ruhet Trashëgimia kulturore.</p> <p>Janë organizuar vizita nëper objekte, Promovime të ndryshme etj.</p>	
2. BLOKU II: KRITERET EKONOMIKE				
1. EKZISTENCA E EKONOMISË FUNKSIONALE TË TREGUT				
1.1. Përmirësimi i mëtejshëm i ambientit në të bërit biznes si dhe procedurat e planifikimit të buxhetit		<p>1.A është themeluar Qendra për regjistrimin e bizneseve (<i>one-stop shope</i>) në komunën tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i inspektorëve të tregut në komunën tuaj?</p> <p>3. Sa është numri i inspektimeve gjatë periudhës raportuese?</p> <p>4. Sa dëgjime publike janë mbajtur për planifikimin e buxhetit?</p> <p>5.Sa është numri i bizneseve të regjistruara, ju lutem</p>	<p>1. Po, Komuna e Mitrovicës e ka të themeluar Qendrën për Regjistrim të Bizneseve (<i>one-stop shope</i>)</p> <p>2. Aktualisht Komuna e Mitrovicës ka 2 inspektor të tregut dhe udhëheqësin e sektorit.</p> <p>3. Inspektorati i tregut gjatë kësaj periudhe raportuese ka kryer gjithsej 221 inspektime.</p> <p>4. Dëgjimet publike për planifikim të buxhetit mbahen në periudhën e dytë raportuese të vitit, pra gjatë muajit korrik.</p> <p>5. Numri i bizneseve të regjistruara për periudhën Janar-Qershor 2024, është 245.</p>	
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik				

		<p>ofroni të dhëna vetëm për periudhën raportuese Janar-Qershor 2024 ?</p> <p>6. 2.Sa është numri i bizneseve të mbyllura, ju lutem ofroni të dhëna vetëm për periudhën raportuese Janar-Qershor 2019 ?</p> <p>7.Sa është numri i bizneseve të udhëhequr nga gratë?</p> <p>8.Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për subvencionimin e bizneseve?</p>	<p>6. Numri i bizneseve të mbyllura për periudhën Janar-Qershor 2024, është 45.</p> <p>7. 139 Biznese janë SH.P.K, -te regjistruara ne emer te burrave kurse 14 në pronësi të grave.</p> <p>Ndërsa, 65 Biznese Individuale në pronësi te burrave dhe 27 biznese në pronësi të grave .</p> <p>8. Për periudhën raportuese, nuk ka pasur subvencionim të bizneseve.</p>	
<p>2. TATIMET</p> <p>2.1.Zvogëlimi i nivelit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal;</p>	<p>Drejtoria e Inspektoriatit</p>	<p>1. Cilat janë masat që ka ndërmarrë komuna juaj ndaj subjekteve ekonomike me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale ?</p>	<p>1. Me qëllim të eliminimit të parregullësiave nga kjo fushë, inspektorati i tregut ka ndërmarr këto masa dhe veprime:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Janë konstatuar me procesverbal 71 subjekte të reja të pa regjistruara; - 32 subjekte kanë plotësuar të dhënat konform 	<p>Neni 105 Tatimet - MSA</p>

<p>2.2. Zbatimi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike</p>	<p>Drejtoria për Bugjet Financa</p>	<p>1. Sa rekomandime ka dhënë Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) në raportin më të fundit për Komunën tuaj.</p> <p>2. Sa rekomandime të ZKA-së i keni adresuar?</p> <p>3. Sa rekomandime të ZKA-së kanë mbetur pa u adresuar?</p> <p>4. Sa rekomandime të ZKA-së gjenden në proces?</p> <p>5. A funksionon Njësia e Auditimit të Brendshëm në komunën tuaj, nëse po sa zyrtarë janë të angazhuar në këtë njësi?</p> <p>6. A ka themeluar komuna juaj komitetin për auditim të brendshëm?</p>	<p>konstatimit me procesverbal;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kanë aplikuar 51 subjekte që të pajisen me pëlqim për kushte minimale teknike; - Janë shqiptuar 20 gjoba ndaj subjekteve të cilat nuk kanë eliminuar parregullësit e konstatuara nga ana e inspektorëve të tregut. <p>Janë ndaluar përkohësisht 8 subjekte deri në eliminimin të parregullësive.</p>	
	<p>Njësia e Auditimit të brendshëm</p>	<p>1.Nga raporti i auditimit kanë rezultuar 11 rekomandime.</p> <p>2. Janë zbatuar 5 rekomandime.</p> <p>3. Pa zbatuar kanë mbetur 4 rekomandime.</p> <p>4. Në proces janë 2 rekomandime.</p> <p>5.Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Mitrovicës së Jugut është themeluar nga data 07.05.2008 dhe janë të angazhuar 3 anëtar. Drejtori i NJAB dhe dy Auditor të Brendshëm.</p> <p>6.Po, është themeluar me vendim të kryetarit me 06.02.2024 në përbërje prej 5 anëtareve.</p>		

2.3. Planifikimi i pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal		1. A është publikuar regjistri i pronës komunale, bashkangjithni linkun i regjistrit të pronave në kuadër të ueb faqeve zyrtare të komunave ?	<p>1.Po, Komuna e Mitrovicës ka të publikuar në ueb faqen zyrtare të saj Listën e përgjithshme dhe të veçantë të pranova të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024.</p> <p>https://kk.rks-gov.net/mitrovicejgut/wp-content/uploads/sites/18/2024/01/Lista-e-pergjitshme-dhe-e-vecante-e-pronave-te-cilat-planifikohen-per-dhenie-ne-shfrytezim-per-vitin-2024.pdf</p> <p>Në vijim keni edhe linkun për Pronat Komunale.</p> <p>https://kk.rks-gov.net/mitrovicejgut/?page_id=100046347</p>
3. NDËRMARRJET DHE POLITIKAT E INDUSTRIË			
3.1.Ndërtimi i një infrastrukture fizike, të kompletuar dhe të gatshme për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	1. A është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike në komunën tuaj?	<p>1. Komuna e Mitrovicës ka dy zona ekonomike (Parku i Biznesit dhe Parku Industrial në Frashër).</p> <p>Parku i biznesit është zonë ekonomike funksionale me biznese të vendosura.</p> <p>Ndërsa, Parku Industrial në Frashër, është zonë e cila ka nevojë për investime në infrastrukturë për ta bërë funksionale. Komuna e Mitrovicës ka filluar me projektin në vlerë prej 250.000€ për rregullimin e Infrastrukturës në këtë zonë.</p> <p>Gjithashtu gjatë periudhës së dytë të vitit 2023, është shpallur konkursi publik për 14 parcela në Zonën e lirë ekonomike në Frashër, i cili tashmë është në procedurë. Me vendim të kuvendit, janë dhënë 14 parcela. Është nënshkruar edhe arrëveshja me MINT-in për bashkëfinancim për rregullim të infrastrukturës në vlerë 1.1 milion euro për periudhën 2024-2025.</p>

3. BLOKU III: STANDARDET EVROPIANE

1. BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

Neni 26 i MSA-së: Bujqësia dhe Peshkataria

<p>1.1. Rregullimi i mëtejshëm i tokës bujqësore dhe mbrojtjes nga ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore</p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Plan Program për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar?</p> <p>2. Sa është numri i kërkesave të parashtruara për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore?</p> <p>3. Sa është numri i vendimeve të miratuara për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore?</p> <p>4. A keni raste në komunën tuaj të humbjes së tokës Bujqësore?</p>	<p>1. Jo, komuna jonë nuk e ka të hartuar Plan Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.</p> <p>2. Për periudhën raportuese, kemi pasur vetëm një kërkesë për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.</p> <p>3. Nuk kemi vendime të miratuara nga DBZHR-ja.</p> <p>4. Po ka raste të humbjes së tokës bujqësore</p>	
<p>1.2. Konsolidimi i mëtejshëm i qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural</p>	<p>Drejtoria për Bujqësi</p> <p>1. A janë funksionalizuar qendrat informative për këshillimin e fermerëve në komunën tuaj?</p> <p>2. A ka mbështetur komuna juaj fermerët në sektorin e</p>	<p>Drejtoria për Bujqësi</p> <p>1. Po qendrat informative për këshillimin e fermerëve në komunë, janë funksionalizuara.</p> <p>2. Po komuna në bashkëfinancim me donator ka mbështetur këto sektorë:</p>	

			drithrave, hortikulturës, blegtorisë etj nëse po ju lutem cekni sektorin dhe numrin e fermerëve të përkrahur?	Në bashkfinancim me Islamic Relife Kosova - Mekanizim - 127 fermer - Panele Solare - 8 fermer Në bashkfinancim me Qatar Charity: - Hapja e puseve për ujë të pijshëm - 16 fermer	
1.3. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e tokës bujqësore	Drejtoria për Bujqësi	1.Çfarë veprime ka ndërmarr komuna juaj për parandalimin e humbjes së tokës bujqësore?	1. Komuna e Mitrovicës nuk ka Inspektor të Bujqësisë, andaj edhe nuk kemi mundur të ndërrmarim veprime ligjore rreth kësaj qështje, por mundohmi që parandalimin e humbjes së tokës bujqësore ta parandalojm përmes këshillave të realizuara nga këshilltarët komunal		
1.4. Planet për tokave rurale (zonumi)	Drejtoria e Bujqësisë	1. A posedon komuna e juaj Planin për Menaxhimin e tokave rurale, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar ?	1. Jo, komuna e Mitrovicës, nuk ka Plan për Menaxhimin e Tokave Rurale.		
ENERGIJA					
2.1. Reformimi i strukturave institucionale në fushën e energjisë dhe ngritja e kapaciteteve të tyre, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis-së së transpozuar	Drejtoria e Shërbimeve Publike	1. A ka miratuar komuna juaj Planin për Efiqencë të Energjisë, konform Ligjit për Energi Elektrike nëse po, ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar ? 2. Cilat janë projektet konkrete për zbatimin e planit për efiqencë të	1. Komuna e Mitrovicës së Jugut, nuk e ka të hartuar Planin për Efiqencë të Energjisë. 2. Projektet konkret në këtë periudhë raportuese janë 6: •SHF: “Skënderbeu” •Qendra e Kulturës “Rexhep MITROVICA” •QMF Bare •QMF Baigorë dhe 2 ndërtesa sociale të cilat janë në proces:	Neni 114 Energjia- MSA	

		energjisë, specifikoni së paku tri projekte?	ndërtesa Sociale "DES-i" dhe ndërtesa sociale në Shipol. (Të dhëna nga zyrtari për Eficiencë)	
4. GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE				
4.1.Zbatimi i pakove ligjore për të drejtat e njeriut		<p>1. A është emëruar zyrtari përkatës për mbrojtjen nga diskriminimi?</p> <p>2.A është emëruar zyrtari përkatës për Barazi Gjinore?</p> <p>3. Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e të drejtave të njeriut ?</p>	<p>1. Njësia për të Drejtat e Njeriut, është e themeluar që nga viti 2008, ku në kuadër të Njesisë janë Shefi i Njesisë për të drejtat e Njeriut, Zyrtarja për Barazi Gjinore, dhe Zyrtari për Komunitete, mbrojtja nga diskriminimi mbulohet nga Njësia për të drejtat e Njeriut në kauder të Njesisë.</p> <p>2. Që nga viti 2008, në kuadër të Njesisë për të drejtat e Njeriut, e kemi edhe Zyrtaren për Barazi Gjinore.</p> <p>3. Njësia për të drejtat e Njeriut për vitin 2024, ka të ndarë Shumen prej 20.000 (njëzetmijë) Eurove, për përkrahje të OJQ-ve, të cilat merren me mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Njeriut.</p>	
		Njësia për të Drejtat e Njeriut		

<p>4.2 Zbatimi i pakove ligjore për Kujdesin për të moshuarit</p>	<p>Drejtoria për Mirëqenie Sociale / Qendra për Punë Sociale</p>	<p>1.A ofron Komuna juaj përkuqjesje rezidenciale për të moshuarit, konform legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë? 2.Nëse po, sa qendra të përkuqjesjes për të moshuarit gjenden në Komunën tuaj?</p>	<p>Përgjigje në Pyetjet 1. dhe 2. Jo komuna nuk ofron përkuqjesje rezidenciale për të moshuarit, mirëpo si QPS-Mitrovica e Jugut kërkesat e qytetarëve të Mitrovicës për strehim i adreson në SHPMPF Prishtinë dhe vende të tjera të dedikuara për këto kategori. Vlen të specifikohet se, nuk ka pasur ndonjë kërkesë nga qytetarët që nuk e kemi përmbushur, njëkohësisht është planifikuar ndërtimi i një shtëpie për persona të moshuar në Mitrovicë dhe atë për vitin 2024.</p>	
---	---	---	---	--

<p>4.2. Të drejtat e grave dhe barazia gjinore</p>	<p>Drejtoria për Mirëqenie Sociale /</p>	<p>3. A ka hartuar komuna juaj Planin e Veprimit kundër dhunës në familje, konform strategjisë kombëtare nëse po ju lutem të bashkangjiteni dokumentet e miratuar ?</p> <p>4.. Sa raste të dhunës mbi baza gjinore ka trajtuar komuna <u>juaj dhe sa janë trajtuar ?</u></p> <p>5.. Cfarë masa ka ndërmar komuna juaj për viktimat e dhunës në familje konform ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje ?</p> <p>6.A ka themeluar komuna këshillin komunal (komitet) për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, nëse po sa takime janë mbajtur?</p>	<p>3. Komuna e Mitrovicës së Jugut, nuk e ka të hartuar Planin e Veprimit kundër dhunës në familje (i ka skaduar afati). Hartimi i këtij plani, është në proces.</p> <p>4. QPS si institucion profesional i nivelit komunal përgjatë periudhës Janar - 28.06.2024, ka trajtuar (26) njëzet e gjashtë raste të dhunës mbi baza gjinore të reja dhe (29) njëzet e nëntë raste të dhunës në familje recidive (të përsëritura).</p> <p>5. Konform mandatit të saj QPS ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme që nderlidhen me mandatin e saj dhe atë në bashkëveprim me institucionet e tjera ndervepepruese .</p> <p>Qendra për Punë Sociale (QPS) Mitrovica e Jugut në vazhden e përpjekjeve dhe masavae parandaluese kundër dhunës në famailje dhe dhunës në baza gjinore, vetëdijesimit të nxënësve nga pasojat e martesave para moshës madhore në mbështetje të DMS-së ka mabjtur takime sensibilizuese në : SHFMU Musa Hoti ,SHFMU „Bedri Gjinaj , SHMLM „ Dr. Xheladin Deda “ dhe SHMLA ,Hasan Prishtina në tema si :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Koordinimi ndërinstitutional për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore me theks mbrojtjen e fëmijëve në menyrë sa më të theksuar ,kur ata janë te ekspozuar nga çfardo lloj dhune në familje apo të ndonjë forme tjetër të dhunës dhe • Vetdijesimi për pasojat e mundëshme nga
--	---	---	--

		<p>Zyra për Barazi Gjinore</p>	<p>martesat e hershme .</p> <p>Bashkëpunimtarët ishin edhe akteret e tjerë institucional si:</p> <p>Gjykata Themelore e Mitrovicës</p> <p>Prokuroria Themelore e Mitrovicës</p> <p>Policia e Kosovës dhe</p> <p>OJQ - Center for Education and Community Development Friends .</p> <p>Takime të tilla të karakterit sensibilizues dhe parandalues do të vazhdojnë ti mbajmë edhe në fillim të vitit të ri shkollor 2024/2025 dhe atë edhe në shkollat e viseve rurale .</p> <p>6. Komuna e Mitrovicës e ka të themeluar mekanizmin për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.</p> <p>Gjatë periudhës së parë të vitit nuk janë mbajtur takime, ndërsa për periudhën e dytë të vitit, nuk janë ofruar informata.</p>
--	--	--------------------------------	---

4.3.Të fuqizohet roli dhe pozita e grave në shoqëri		<p>1. Sa është numri i grave në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet e komunës duke përfshirë dhe komunitetin jo shumicë (p.sh. administratë, shkolla, QMF etj) ?</p> <p>2.Sa është numri total i përfaqësimit të grave në administratën publike lokale duke përfshirë Kuvendin e Komunës, dhe komunitetin jo shumicë ?</p> <p>3. Sa është numri i grave që janë Drejtore të Drejtorive në Komunën tuaj?</p>	<p>1. Në Administratën Komunale, numri i grave në pozita menaxheriale, duke përfshirë edhe komunitetin jo shumicë është: 4 (prej tyre 3 shqiptare dhe 1 serbe); Në Institucionet e Arsimit Parauniversitar, numri i grave në pozita menaxheriale, është: 17, (asnjë nga komuniteti jo shumicë); Në Institucionet e Kujdesit Primar Shëndetësor, numri i grave në pozita menaxheriale, është: 26 (asnjë nga komuniteti jo shumicë);</p> <p>Gjithsej: 47 gra në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet e komunës duke përfshirë edhe komunitetin jo shumicë.</p>	
	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut</p> <p>Burimet Njerëzore</p>		<p>7. Në Administratën Komunale, janë 126 gra zyrtare publike (prej të cilave 8 janë nga komuniteti jo shumicë dhe 1 staf politik); Numri i grave asambleiste, është 12 (asnjë nga komuniteti jo shumicë) Gjithsej: 138 numri total i grave të përfaqësuara në administratën publike lokale, Kuvendin e Komunës duke përfshirë edhe komunitetin jo shumicë.</p>	
4.4.Zbatimi i të drejtave pronësore	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete/Zyra për Barazi</p>	<p>1. Cilat janë veprimet që ka ndërmarr komuna juaj me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat</p>	<p>8. Numri i grave që janë Drejtore të Drejtorive në Komunën tonë, ka qenë 4. Tani në këtë periudhë raportuese, është 3. Ndërsa vlen të theksojmë se Kryesuesja e Kuvendit poashtu është femër</p>	
			<p>1. Për periudhën raportuese, nuk ka pasur aktivitete lidhur me rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave.</p>	

	Gjinore/ Kadastri	<p>pronësore të grave, dhe cila është natyra e tyre?</p> <p>2. Sa prona janë të regjistruara në emër të dy bashkëshortëve?</p>	<p>2. Në DGJKP në vitin 2023 janë regjistruar 322 prona, ne emër të dy bashkëshortëve, por për 6 mujorin e parë 2024, nuk na janë ofruar të dhëna!</p>	
<p>4.5. Zbatimi i Ligji për Mbrojtjen e fëmijës</p>	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete</p>	<p>1. Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqësohet komuna juaj në zbatimin e ligjit për mbrojtjen e fëmijës?</p> <p>2.A është themeluar ekipi për të drejtat e fëmijës sipas UA.06/22 .</p> <p>3. A është organizuar ndonjë fushatë vetëdijësues-edukese në komunën tuaj mbi promovimin dhe njohjen e të drejtave të fëmijëve në kuadër të EDF.</p> <p>4. A është caktuar zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës ?</p> <p>5. A janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, hapësirat e punës në institucionet publike?</p> <p>6.A janë të qasshme</p>	<p>1. Sfidat me të cilat ballafaqohet Komuna e Mitrovices se Jugu, ne zbatim të ligjit per mbrojtjen e femijes,ende nuk kemi zyrtarin per mbrojtjen e femijes,por kete detyre e kryen zyrtarja per barazi gjinore, mungesa e fondeve te ndara ne kuader te Ketij ligji.</p> <p>2. Po, Komuna e Mitrovices e ka te themeluar Ekipen per te drejtat e femijes.</p> <p>3. Njësia per te drejtat e Njeriut, ka perkratur ne mjete financiare OJQ-te, qe merren me mbrojtjen dhe promovimin e te drejtave te femijeve,si dhe kemi mbajtur Ligjerta ne Shkolla te Mesme te Ulta, per te drejtat e Femijeve.</p> <p>4. Jemi, duke pritur qe gjate ketij viti te behet Rekrutimi i nje zyrtari per mbrojtjen e Femijes.</p> <p>5. Objekti i Komunes se Mitrovices, eshte i Qasshum per Persoant me Aftesi te Kufizuar, sepse kati Perdhes eshte Renovuar i teri gjate vitit 2023, dhe te gjitha Sherbimet kryhen ne katin Perdhes dhe eshte i Qasshum, per Persoant me Aftesi te Kufizuar, por kemi edhe disa Objekte tjera Perjellse, te cilat fatkeqsisht nuk kane qasje per Persoant me Aftesi te Kufizuar.</p>	

	Arsimit	<p>objektet arsimore për personat me aftësi të kufizuara?</p> <p>7.A kane asistencën e duhur në procesin mësimor fëmijët me aftësi të kufizuara, sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë?</p> <p>8. A ofron Komuna Juaj kujdestari për fëmijës pa përkujdesje prindërore sipas formave themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare, bazuar në legjislacionin në fuqi.</p>	<p>6. Objektet arsimore janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara</p> <p>7. Ne disa Shkolla ku fëmijet me Aftësi të kufizuara Shkollën ne Shkolla, kane Asistencën e Duhur, ku ne si Komuna e Mitrovicës, kemi disa Asistentet që ju ndihmojnë ketyre fëmijeve.</p> <p>8. Komuna ju ofron kujdestari fëmijeve pa përkujdesje prindërore, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.</p> <p>Qendra për Punë Sociale brenda mandatit të saj ofron format themelore të mbrojtjes Juridike dhe familjare dhe atë siq janë :</p> <p>Strheimi familjar brenda familjes (familjes biologjike)</p> <p>Strehimi familjar jashtë familjes</p> <p>Strehimi rezidencial dhe</p> <p>Adoptimi</p>	
4.6.Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore	DMSJ/ QPS-ja	<p>1. A është e hapur fushata vjetore në parandalimin e trafikimit me njerëz në Komunën tuaj? Nëse po ju lutem renditni aktivitetet?</p> <p>2.A e ka të miratuar Komuna Juaj Planin tre-vjeçar për strehim Social</p>	<p>1. Ne si Njesi për të drejtat e Njeriut kemi një nenkod buxhetore në shumën prej 20.000 Eurove, dhe me keto mjete Financiare i Perkrhim të Gjitha OJQ-te, që merren me Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut, të drejtat e fëmijeve, të drejtat e Komuniteteve, Parandalimin e trafikimit me QENIE Njerëzore, dhe ne si Njesi se bashku me të gjitha Institucionet tjera marrim pjesë në fushatën Vjetore.</p> <p>2. Komuna e Mitrovicës e ka të miratuar Planin (3) tre vjeçar për banim 2022-2025 i cili ika kaluar edhe të gjitha procedurat ligjore nga miratimi në KPF-së dhe Kuvendin komunal dhe njëherazi është</p>	
	Zyrtarja për Banim Social			

	(Drejtoria për Urbanizëm)	konform Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit ? Nëse po ju lutem ta bashkëngjitni Planin?	konfirmuar edhe nga Ministria kompetente mbi ligjshmërinë e këtij dokumenti. Linku: https://kk.rks-gov.net/mitroviccejugut/wp-content/uploads/sites/18/2022/12/Programi-trevjecar-i-banimit-2022-2025.pdf	
4.7. Incimi i funksionalizimit të Komunitetit Konsultativ për Personat em Aftësi të Kufizuar	Sekretaria e Kuvendit	1. A është themeluar Komiteti konsultativ për Personat me aftësi të kufizuara në komunën tuaj? Nëse po sa takime ka mbajtur?	1. Po Komuna e Mitrovicës së Jugut e ka të themeluar Komitetin Konsultativ për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Aftësi të Kufizuara.	
4.8. Ofrimi i ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallim etnie 7 (shtatë) regjione të Republikës së Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë dhe Gjilan.	Drejtoria e Administratës	1. A është funksionalizuar Zyra Rajonale për ndihmë juridike falas ? (Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë). 2. A janë themeluar në komunë tuaj Zyrat mobile për ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike konform Ligji nr. 04/1-017 për ndihmë juridike falas 3. Sa është numri i kërkesave për ndihmë juridike falas në komunën tuaj?	Pyetjet : 1. 2. Dhe 3. Po Zyra për ndihmë Juridike është funksionale dhe ushtron veprimtarinë e saj në Rr. Afrim Zhitia në Mitrovicë. <i>Zyra Rajonale për ndihmë juridike falas, nuk është nën kompetencë të komunës.</i>	

5 .MBROJTJA E MINORITETEVE

<p>5.1. Buxheti dhe sfidat në nivel qendror dhe lokal</p>		<p>1. Sa është numri i të punësuarve në të gjitha institucionet e komunës, nga komunitet jo shumicë në pajtim me përqindjen e popullatës në komunë?</p>	<p>Në Administratën Komunale, numri i të punësuarve nga komunitet jo shumicë është: 15</p> <p>Në Institucionet e Arsimit Parauniversitar, numri i të punësuarve nga komunitet jo shumicë është: 12</p> <p>Në Institucionet e Kujdesit Primar Shëndetësor, numri i të punësuarve nga komunitet jo shumicë është: 5</p> <p>Gjithsejtë: 32 numri i të punësuarve në të gjitha institucionet e komunës, nga komuniteti jo shumicë.</p>	
<p>5.2. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Komunitetet Rom dhe Ashkali, përmirësimi i shkallës së regjistrimit civil për komunitetet rom, dhe ashkali</p>	<p>Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim</p>	<p>1. A është realizuar fushata për regjistrimin falas të Komuniteteve Rom Ashkali dhe Egjiptian?</p> <p>2. A është miratuar Planit Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjitni këtë Plan? (për komunat që i kanë këto komunitetet)</p> <p>3. A është themeluar komiteti lokal veprues për zbatimin e Strategjisë për komunitetin Rom dhe Ashkali.</p>	<p>1. Për periudhën raportuese, nuk janë realizuar fushata për regjistrimin falas të Komuniteteve Rom dhe Ashkalinjë.</p> <p>2. Planit Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunën tonë, nuk është miratuar.</p> <p>3. Komuna e Mitrovicës e ka të themeluar Komitetin e Përhershëm për komunitete.</p>	

6. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA		Neni 83 Liria, Siguria dhe Drejtësia- MSA
6.1.Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përfruar	1.A është miratuar Planin Lokal i Veprimit për Riintegrim në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar? 2.A ka themeluar komuna juaj Komisionin Komunal për Riintegrim (KKR)?	1. Po komuna jonë e ka të miratuar në vitin 2023, Planin Lokal të Veprimit për Riintegrim të cilin do ta gjeni të bashkëngjitur në dokumentat përcjellëse. 2. Po, komuna e ka të themeluar Komisionin Komunal për Riintegrim.
Zyra Komunal për Kthim dhe Komunitete		
7.MENAXHIMI I KUFIJVE DHE MIGRIMIT		
7.1. Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur	1. Sa është numri i personave të zhvendosur të rikthyer, të cilët janë regjistruar në komunën tuaj? 2. Sa është numri i shtëpive të (ri)ndërtuara për të rikthyerit? 3. Sa është numri i aplikimeve për asistencë nga	1. Sa i përket personave të zhvendosur , të rikthyer të komuniteteve në këtë periudhë 6 mujore, nuk ka pasur zyrtarisht të lajmruar pran zyrës tonë. 2. Ne si zyre, nuk kemi informata për nr. te shtëpive të rindërtuara, renovuara për të rikthyerit. 3. Ne gjashtë mujorin e parë kemi 13 Kërkesa të personave të riatdhesuar, personave të kthyer nga shtetet Evropiane.
Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim/ Zyra për Riintegrim dhe Riatdhesim		
Neni 85- Vizat,menaxhimi i kufijve, azili dhe migracioni- MSA		

		<p>fondi për ri-integrim?</p> <p>4. Sa është numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riatdhesuar?</p>	<p>Kryesisht janë Kërkesa për ;pagesë Qiraje dhe vazhdim të qirasë.</p> <p>4. Për çdo vit, zakonisht kemi 2 apo 3 thirrje publike nga organet e autorizuar nga MPB-ja, Departamenti për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar për Aplikim për Plan Biznes, mjete të punës.</p> <p>Por deri me tani, nuk ka pasur thirrje për aplikim, pritet në gjashtëmujorin e dytë të shpallet Thirrja për Aplikim</p>
<p>7.2. Puna dhe roli i Këshillat Lokale për Siguri Publike, (KLSP) dhe Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi, (EVSB) të cilat përveç që duhet të jenë funksionale ato duhet të jenë edhe produktive</p>	<p>Zyra e Kryetarit të Komunës</p>	<p>1. A është themeluar KKSB në Komunën Tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga KKSB ?</p> <p>3. A është themeluar Këshilli Lokal për Siguri Publike (KLSP) në komunën tuaj ?</p> <p>4. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga (KLSP) ?</p> <p>5. A është themeluar EVS në Komunën tuaj?</p>	<p>1. Po, KKSB-ja është e themeluar.</p> <p>2. Gjatë periudhës janar - qershor 2024 janë mbajtur gjithsej 2 takime.</p> <p>3. Po Këshillat Lokal për Siguri publike janë themeluar, dhe aktualisht në komunën tonë funksionojnë.</p> <p>4. KLSP-të të cilat janë duke funksionuar në komunën tonë kanë takime të rregullta nëpër lagjet e tyre.</p> <p>5. EVSB është themeluar në vitin 2014 në bashkëpunim me ICITAPI-n amerikan.</p>

10. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatrave Vinarc i Ulët dhe Vinarc i Epërm
11. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatit Gushavc
12. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatit Zhabar i Ulët
13. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatit Zhabar i Epërm
14. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatrave Vllahi dhe Zijaqë
15. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatrave Mazhiq, Rasha dhe Tërstenë
16. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Lagjes "2 Korriku" dhe Fshatit Lisicë
17. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Lagjes Shipol dhe Fshatit Lushtë
18. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatrave Kutllovc dhe Tunel i Parë
19. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të fshatrave Vidishiq dhe Selac
20. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të fshatrave Trepçë dhe Stantërg
21. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatit Rahovë
22. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të fshatrave Vaganicë e Ulët dhe Vaganicë e Epërme
23. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të fshatrave Frashër i Madh dhe Frashër i Vogël
24. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Lagjes Qendër dhe Lagjes Adem Voca
25. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Fshatit fshatrave Melenicë dhe Maxherë
26. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Lagjes Ura e Gjakut

			<p>27. Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të të Lagjes Bair</p> <p>Vendim Për emërimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit lokal të Lagjes Iliridë</p> <p>8. Për periudhën raportese, i kanë mbajtur 5 takime.</p>	
8. ARSIMI DHE KULTURA				
<p>8.1.Ngritja e kapaciteteve teknike për Arsimin Gjithpërfshirës</p>	Drejtoria e Arsimit	<p>1. Sa trajnime janë mbajtur gjatë periudhës raportuese për mësimdhënës ?</p>	<p>1.Gjatë kësaj periudhe raportuese janë mbajtur 4 trajnime: 1 trajnim për menaxhimin e klasës për mësimdhënësit e nivelit fillor (Klasat 1-5) dhe 1 trajnim për mësimdhënësit e nivelit të mesëm të ulët (Klasat 6-9), si dhe janë mbajtur 2 trajnime për edukatorët e klasave përgatitore dhe edukatorët e çerdheve.</p>	Neni 107 Arsimit dhe trajnimi - MSA
<p>8.2. Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe fëmijët me nevoja të veçanta</p>	Drejtoria e Arsimit	<p>1. Sa është numri i çerdheve funksionale (<i>publike dhe jo-publike</i>) në komunën tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i fëmijëve prej moshës 0-5 vjec që janë të përfshirë në çerdhe?</p> <p>3.Sa është numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët janë përfshirë në çerdhe?</p>	<p>1. Numri i çerdheve funksionale (<i>publike dhe jo-publike</i>) në komunën tonë është 6 çerdhe.</p> <p>2. Numri i fëmijëve prej moshës 0-5 vjec që janë të përfshirë në çerdhet publike është 280 fëmijë.</p> <p>3. Numri i fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët janë përfshirë në çerdhe është 17 fëmijë.</p>	

<p>8.3. Raportim me të dhëna mbi numrin e braktisjes së shkollimit nga komuniteti pakicë, në veçanti komuniteti Rom Ashkali Egjiptian. Veprimet konkrete të ndërmarra nga komuna në parandalimin e mëtejshëm të braktisjes së shkollimit</p>	<p style="text-align: center;">Drejtoria e Arsimit</p>	<p>1. Komuna juaj a has në mungesë të librave shkollore në gjuhët e komuniteteve pakicë?</p> <p>2. Sa është numri i rasteve të braktisjes së shkollimit nga komuniteti jo shumicë?</p> <p>3. A ka organizuar komuna juaj trajnime për ekipet e parandalimit të braktisjes së shkollës, nëse po ju lutem specifikoni numrin e trajnimeve?</p> <p>4. A ka hartuar komuna juaj Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit e shkollimit për komunitet jo shumicë (rom dhe ashkali) konform strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, nëse po ju lutemi të bashkangjiteni këtë Plan?</p> <p>5. A janë formuar ekipet për parandalimin e braktisjes së nxënësve në shkolla në komunën tuaj?</p>	<p>1. Komuna e jonë nuk has në mungesë të librave shkollore në gjuhët e komuniteteve pakicë. Në vazhdimësi sigurohen tekstet në gjuhën boshnjake dhe turke.</p> <p>2. Nuk ka raste të raportuara të braktisjes së shkollimit nga komuniteti jo shumicë.</p> <p>3. Nuk kemi organizuar trajnime në këtë periudhë, ngase jemi në fazën e rifunksionalizimit të ekipeve.</p> <p>4. Komuna ka hartuar dhe aprovuar në asamble "Planin komunal të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë (2024 - 2026)".</p> <p>5. Po, janë formuar ekipet për parandalimin e braktisjes së nxënësve në të gjitha shkollat dhe në nivel komunën dhe tani jemi në fazën e rifunksionalizimit dhe fuqizimit të tyre, sipas planit komunal të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë (2024 - 2026)".</p>	
--	---	---	--	--

9. MJEDISI	Neni 115 Mjedisi- MSA		
<p>9.1. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë</p>	<p>1. A është hartuar plani komunal për menaxhimin e mbeturinave konform ligjit nr. 04/1-060 për mbeturina. Nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar?</p> <p>2. Sa është numri i fushatave të ndërmarrja për ndërgjegjësimin publik për sistemin e menaxhimit të mbeturinave?</p> <p>3. Cilat janë veprimet e ndërmarrura nga komuna e Obiliqit për mbrojtjen e qytetarëve lidhur me mbylljen e liqenit të depozitës së hirit të qymyrit që operohet nga KEK-u dhe deponisë së Mirashit ? Obiliqi</p> <p>4. A është hartuar plani i veprimit për cilësinë e ajrit në komunën tuaj, konform Ligjit nr. 03/1-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar (<i>shihni nëse Planet lokale të veprimit për cilësinë e ajrit janë pjesë integrale e</i></p>	<p>1. Po është hartuar dhe miratuar Planin Lokal për Menaxhim Mbeturinave per periudhën 2023-2028, 02-060/01-0053918-8/23 te datës 26.07.2023.</p> <p>2. Gjatë këtij viti janë organizuar mbi 3 fushata vetëdijesuese në bashkëpunim me shoqëri të civile</p> <p>Ka vazhduar Vendosja e shenjeve vetëdijesuese për respektimin e ligjit dhe venjen e gjobave për ndotësit e ambientit.</p> <p>Shpërndarja e Shportave për Shipol, Vaganicë e Zhabar dhe vetëdijesimi mi orarin e rregullt te shërbimit!</p> <p>Me datën 22.04.2024 dita nderkombetare e Tokës vendosja e shportave për plastikë afër liqenit artificial.</p> <p>(masa 3 vlenë për komunën e Obiliqit)</p> <p>4. Komuna e Mitrovicës, nuk ka Plan të veprimit për cilësinë e ajrit.</p>	
<p>Drejtoria e Shërbimeve Publike</p>			

9.2 Numri i madh i deponive ilegale duhet të adresohet urgjentisht	Drejtoria e Shërbimeve Publike	1. Sa është numri i deponive ilegale në komunën tuaj dhe çfarë masa ka ndërmarrë komuna për të eliminuar këto deponi?	<p>1. Deponi të mbeturinave të hedhura ilegalisht, janë regjistruar 18, ku janë eliminuar 3. Gjithsej tani janë 15 deponi!</p> <p><u>Vërejtje: numri i deponive mund të ndryshoj për çdo ditë, mirpo, Komuna e Mitrovices është shumë vigjilente në shqiptimin e gjobave mandatore, me cka dhe ka berë që numri i deponive mos të rritet në numër të theksuar!</u></p>	
10. MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE E SHËNDETTIT PUBLIK				
10.1 Mbrojtja e Shëndetit të Nënës, Fëmijës dhe Shëndetit Riprodhues	Drejtoria e Administrates /Drejtoria e shëndetësis	1. A ka pasur fushata vetëdijësues në komunën tuaj lidhur me shëndetin riprodhues? 2.Sa trajnime ka organizuar komuna juaj për shëndetin e nënës dhe e fëmijës? 3. A janë të qasshme objektet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuar?	<p>1. Po. Në Janar kemi pasur 10 sesione informuese me gra ne kuadër të fushatës "Java europiane e preventivës së kancerit të qafës së mitrës " - kujdesin për shëndetin e gruas dhe shëndetit riprodhues .</p> <p><u>Në Shkurt -5 sesione informuese për rëndësinë e Mars - 4 sesione informuese për planifikim familjar .</u></p> <p>Prill - 4 sesione informuese për gatitje për planifikim familjar , përfshirja e barabart , ruajtja e shëndetit riprodhues .</p> <p>Maj - 3 sesione informuese me tematik të njëjtë.</p> <p>Qershor - 2 sesione me tematik të njëjtë.</p> <p>2. Në periudhën Janar - Qershor janë organizuar 4 trajnime për shëndetin e nënës dhe e fëmijës .</p> <p>3. Drejtoria për Shëndetesi, është kompetente për ofrimin e shërbimeve shëndetësore ne Kujdesin Paresor Shëndetësor, ne Komunen e Mitrovices.</p>	Neni 81 Mbrojtja e konsumatorit- MSA

				<p>Ku nga 24 objekte që ofrohen shërbimet shëndetësore, të kujdesit Parësor Shëndetësor, 23 janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, ndërsa 1 nuk është e qasshme, e cila shumë shpejt do të rregullohet</p>	
--	--	--	--	--	--